




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë /a/e:	27.01.2020
Referencë:	07-353/04-11787/20
Për / Za/ To:	Advors Agency ,Kosovare Maliqi , Prishtina
Nga/ Od/ From:	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Kontrollloi:	Habib Qorri
Punoi:	Sabri Gashi
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim



Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit përmes QSHQ, ka pranuar kërkesën e Advors Agency nga Prishtina, për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin "Zahir Pajaziti". Qëllimi i kërkesës ka të bëjë me organizimin e aktivitetit, ekspozimin e forex ne forme zemre për kreativitet për tu vizituar nga qytetaret .

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, nën shkronja g), i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, nr.01-110-157481, i jep

Pëlqimin

Advors Agency për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin „Zahir Pajaziti“ para Hotel Grandit.

Shfrytëzimi i hapësirës ka të bëjë me organizimin e aktivitetit ekspozim të forexit me dim 2.20 lartesi dhe 1.10 cm bazamenti në forme zemre e cila dhe lidhet me Ditën e te dashuruarve 14 Shkurtit.

Organizimi i aktivitetit –ekspozimi i imazhit lejohet të mbahet nga 11.02.2020-13.02.2020, Për mbajtjen e aktivitetit ekspozohet forexi me imazh te biçikletës me zemër dhe shporte lulesh i cili do të vizitohet nga qytetaret .

Organizatori obligohet që:

- të mos paraqesin pengesë për lëvizjen e lirë të këmbësorëve;
- të kujdesen mirë që objekti të mos të paraqesë rrezik për qytetarë që lëvizin në këtë pjesë,
- Te mos shpërndaj broshura qe hedhen dhe krijojnë mbeturina .
- pas përfundimit të aktivitetit, të largoje objektin dhe hapësira të jetë e lirë si në gjendjen e mëparshme.

Po ashtu, nëse kërkohet ndonjë urgjencë nga Komuna, hapësira duhet të lirohet në afat kohor të cilin e kërkon Komuna.